



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:046588
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05836153

K.Dh.Shk.II.nr.1134/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve-propozuesëve të masës së sigurisë: 1.A.R. me adresë në rr. “Skenderbeu”, në Lipjan dhe 2.Euroland Group Sh.p.k me seli në Rr. “Skenderbeu” në Lipjan , të cilën me autorizim e përfaqëson Ilir Nikqi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës- kundërshtarit të masës së sigurisë L.M. me adresë në Rr.”...”, - Lokali Euro One Sh.p.k në Fushë Kosovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valdrin Behrami avokat nga Prishtina, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshatrit të masës së sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike, KE.nr.117/2024, i datës 03.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kundërshatrit të masës së sigurisë L.M. me adresë në Rr.”...”, - Lokali Euro One Sh.p.k në Fushë Kosovë , ndërsa Vërtetohet Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike, KE.nr. 117/2024, i datës 03.04.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit: 1. Agon Rexhepi dhe 2. Euroland Group SH.P.K., CAKTOHET masa e sigurimit dhe OBLIGOHET kundërshtari i sigurimit L.M., që të zbatoj vendimin e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë Euroland Group SH.P.K., i cili është marr në Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve të Euroland Group SH.P.K., të mbajtur me datën 26.12.2023, si dhe OBLIGOHET kundërshtari i sigurimit L.M., që të lejoj evidentimin e ndryshimeve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi.

II. I ndalohet kundërshtarit të sigurimit L.M., me numër personal 1005511344, që të bëjë tërheqje, bartje apo transfer në emër dhe për emër të Euroland Group SH.P.K., në çdo institucion bankar në Republikën e Kosovës.

III. DETYROHEN Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës që të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të kundërshtarit të masës së sigurimit L.M., me numër personal 1005511344, deri në shumën prej 50.000.00 €.

IV. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit: 1. Agon Rexhepi dhe 2. Euroland Group SH.P.K., i paraqitur ndaj kundërshtarit të sigurimit L.M., me të cilin kanë kërkuar që të detyrohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, të zbatoj vendimin e Kuvendit të jashtëzakonshëm të aksionarëve të shoqërisë tregtare Euroland Group SH.P.K., të datës 26.12.2023, për ndryshimin e Drejtorit të përgjithshëm nga L.M. në D.F..

V. OBLIGOHEN propozuesit e masës së sigurimit 1. Agon Rexhepi dhe 2. Euroland Group SH.P.K., që në emër të garancisë për masën e caktuar, brenda afatit prej 7 ditësh, nga data e pranimi të këtij aktvendimi, të deponojnë shumën prej 3,000.00 € (tre mijë euro), në Arkën e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa nëse propozuesit e masës së sigurimit brenda afatit të përcaktuar, nuk e deponojnë shumën e lartcekur, respektivisht nuk ia dorëzojnë gjykatës dëshminë mbi deponimin e këtyre të hollave, Gjykata me Aktvendim të veçantë do ta anuloj

masën e sigurimit të caktuar sipas Aktvendimit KE.nr.117/24 të datës 03.04.2024 dhe do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

VI.Ky vendim i dërgohet palëve ndërgjyqëse dhe të gjitha bankave që operojnë në tregun e Republikës së Kosovës.

VII.Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit kundërshtari i masës së sigurimit, (sipas pretendimeve në ankesë), duke i propozuar që të aprovojë ankesën si të bazuar të ndryshohet aktvendimin KE.nr.117/24, i datës 03.04.2024, apo të priset aktvendimi i ankimuar dhe çështjen ta kthejë në rivendosije.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë propozuesi i masë së siguris me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditurit-kundërpropozuesit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, përgjigjes në ankesë, dhe vlerësimit e secilës provë veç e veç si dhe lidhshmërin e tyre, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit/propozuesit e masës së sigurimit 1. Agon Rexhepi dhe 2. Euroland Group SH.P.K., përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi për kompensim të dëmit dhe përjashtim të aksionarit, me propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj të paditurit/kundërshtarit të sigurimit L.M., me të cilin kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të detyrohet kundërshtari i sigurimit L.M., që të zbatoj vendimin e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë Euroland Group SH.P.K., të marr në Kuvendin e jashtëzakonshëm të Aksionarëve të Euroland Group SH.P.K., të mbajtur me datën 26.12.2023 dhe në afat prej 7 ditëve të lejoj evidentimin e ndryshimeve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë; të detyrohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, të zbatoj vendimin e Kuvendit të jashtëzakonshëm të aksionarëve të shoqërisë tregtare Euroland Group SH.P.K., të datës

26.12.2023, për ndryshimin e Drejtorit të përgjithshëm nga L.M. në D.F.; të urdhërohen të gjitha bankat në Kosovë që të bllokojnë shumën deri në lartësinë prej 50.000.00 €, për të gjitha llogaritë bankare të kundërshtarit të masës së sigurimit si dhe ti ndalohe kundërshtarit të masës së sigurimit, që të bëjë tërheqjen, bartjen, apo transferet në emër dhe për emër të Euroland Group SH.P.K., në çdo institucion bankar – Bankat e Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka aprovuar pjesërisht propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit, sepse në rastin konkret propozuesi e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive, sepse nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës bëhet e besueshme se propozuesi Agon Rexhepi ka në pronësi 75%, të aksioneve të shoqërisë në bazë të së cilës ka të drejtën e kualifikuar në vendimmarrje dhe mund të disponojë me të drejtat që janë të përfaqësuara në aksion konform nenit 3 par.1.2 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare (LSHT). Ndër të tjera ka cek se në rastin konkret propozuesit kanë kërkuar që të detyrohet kundërshtari i sigurimit që ta zbatoj vendimin e marr në Kuvendin e jashtëzakonshëm të Aksionarëve të shoqërisë tregtare “EUROLAND GROUP” SH.P.K., të mbajtur me datë 26.12.2023, i cili vendim është marrë me vota unanime të aksionarëve, në përputhje të plotë me nenet 12 dhe 14 të Statutit të shoqërisë “Euroland Group” SH.P.K., dhe me dispozitat e nenit 102,105 dhe 108 të LSHT-së. Kështu sipas nenit 102 të LSHT-së, Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe ka kompetencat në vijim: “...2.9. vendimin për të zgjedhur apo shkarkuar personin apo personat që mbajnë pozitën e Drejtorit Menaxhues; 2.10 vendimin për të zgjedhur apo shkarkuar anëtarët e Bordit të Drejtorëve, nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka Bord Menaxhues sipas Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar;...”. Po ashtu ka cek se edhe me nenin 105 të LSHT-së, përcaktohet se: “1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar:1.1. të gjitha të drejtat e votimit të Aksionarëve në Kuvendin e Aksionarëve janë të barabarta; dhe 1.2. përveç siç është përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni dhe përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të gjitha vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave. [...] Neni 108 i LSHT përcakton se: “1. Aksionarët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, ose Bordi i Drejtorëve, do të përcaktojnë personin ose personat e caktuar për të

shërbyer si drejtorë menaxhues. Personi/at në fjalë kanë kompetencat e përcaktuara në nenin 109 të këtij ligji. Kur ka më shumë se një drejtor menaxhues, Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve mund të përcaktojnë tituj, detyra dhe autorizime të ndryshme për secilin prej tyre. Drejtori menaxhues mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës së Aksionarëve ose të Bordit të Drejtorëve. Drejtori menaxhues nuk ka nevojë të jetë Aksionar. Drejtori menaxhues duhet të jetë person fizik". Gjykata e shkallës së parë vlerëson se bazuar në dispozitat e sipërcituara rezulton se Vendimet e marra në Procesverbalin e Kuvendit të jashtëzakonshëm të Aksionarëve të shoqërisë tregtare "Euroland Group" SH.P.K., të mbajtur me datë 26.12.2023, janë vendime legjitime të marra nga organi kompetent i shoqërisë tregtare, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe statutore dhe janë të detyrueshme për të gjitha aksionarët dhe të punësuarit e shoqërisë. Fakti se kundërshtari i sigurimit nuk pajtohet me vendimin e Kuvendit të aksionarëve, është jo relevant nga shkakut se vendimi i lartcekur rezulton se është marr me vota unanime, ku edhe vet kundërshtari i masës së sigurimit, ka votuar dhe është pajtuar që të tërhiqet nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Kompanisë. Për më tepër pjesëmarrja në përqindjen e aksioneve përcakton edhe vëllimin e të drejtave të aksionarit, prandaj fakti se kundërshtari i sigurimit është aksionar me 25% të aksioneve, nuk nënkupton të drejta të pakufizuara mbi tërë shoqërinë por të drejta të kufizuara në proporcion me pjesëmarrjen në aksione dhe gjithmonë duke respektuar vendimet e organeve të shoqërisë, të marra nga shumica e aksionarëve. Përqindja e aksioneve përcakton fuqinë vendimmarrëse dhe vullneti i shumicës i shndërruar në vendim të Kuvendit të Aksionarëve, si organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë tregtare, përbën vendim të tërësisë së aksioneve respektivisht vendim të shoqërisë tregtare dhe detyron të gjithë aksionarët përfshirë edhe aksionarët të cilët nuk pajtohen me këto vendime. Me vet faktin e pranimit e të qenit aksionar minoritar në shoqëri tregtare nënkuptohet edhe pranimi i vendimeve të kuvendit të marra nga shumica e aksionarëve sipas parimit "një aksion një votë". Po ashtu gjykata vlerëson se është plotësuar edhe kushti i dytë ligjor nga neni 297.1 nën pika b) të LPK-së, se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do t'i shkactohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohet. Kuvendi i Aksionarëve në bazë të autorizimeve statusore dhe ligjore ka të drejtën e plotë të marrë vendime për mënyrën e menaxhimit të shoqërisë dhe zhvillimin e aktivitetit afarist, për të cilat kundërshtari i sigurimit me veprimet e tij po i pamundëson të zbatohen. Kundërshtari i masës së sigurimit, me kontestimin e vendimeve legjitime të Kuvendit të Aksionarëve dhe veprimeve tjera me të cilat pengojnë ushtrimin e kompetencave të organeve të autorizuara të shoqërisë do të mund të

ndikonte në përkeqësimin e aktivitetit afarist dhe gjendjes financiare të shoqërisë. Gjykata po ashtu ia ka ndaluar kundërshtarit të masës së sigurimit L.M. që të bëjë tërheqje, bartje apo transfer në emër dhe për emër të Euroland Group SH.P.K., në çdo institucion bankar në Republikën e Kosovës si dhe të njëjtit ia ka bllokuar llogaritë bankare, deri në shumën prej 50.000.00 €, meqenëse në rastin konkret vlerëson se pa caktimin e masës së tillë propozuesve të masës së sigurimit, do të shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohet, nga shkaku se nga vet deklaratimet e kundërshtarit të propozimit rezulton se i njëjti veçse i ka realizuar mjetet financiare në shumën prej 50,000.00 €. Gjykata vlerëson se kundërshtari i masës së sigurimit mund të ndërmarrë veprime me të cilat do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesve të sigurimit. Për më tepër gjykata vlerëson se nga vet deklarimi i kundërshtarit të masës së sigurimit, rezulton se tërheqja e mjeteve në shumën prej 50,000.00 €, në emër të dividendës është bërë pa miratimin unanim të aksionarëve dhe ndonjë metode tjetër të votimit që kërkon numër më të vogël të votave, siç parashihet në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar sipas nenit 105 të LSHT-së, e nga të cilat veprime të kundërshtarit të masës së sigurimit, gjykata vlerëson se ekziston rreziku që paditësit/propozuesit e masës së sigurimit do të dëmtoheshin në masë të madhe dhe nuk do të mund ta realizonin kërkesën e tyre, në rast se kërkesëpadia rezulton si e bazuar. Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi duke refuzuar propozimin e propozuesve të masës së sigurimit me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, të zbatoj vendimin e Kuvendit të jashtëzakonshëm të aksionarëve të shoqërisë tregtare Euroland Group SH.P.K., të datës 26.12.2023, për ndryshimin e Drejtorit të Përgjithshëm nga L.M. në D.F., pasi që vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 297 par. 1 pika a) dhe b) i LPK-së, për caktimin e masës së tillë, sepse shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat është kërkuar që të vendoset kjo masë e sigurimit janë të pabazuara në tërësi. Gjykata e mori këtë vlerësim juridik për arsye se propozuesit e masës së sigurimit nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe rrezikun se pa caktimin e masës së tillë, pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit. Kjo për faktin se sipas nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së, masa e sigurimit ka për qëllim vetëm sigurimin e kërkesëpadisë, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, ndërsa në rastin konkret

rezulton se paditësit/propozuesit e masës së sigurimit, me anë të kërkesëpadisë kanë kërkuar kompensimin e dëmit dhe përjashtimin e aksionarit L.M. nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa me masë të sigurimit kanë kërkuar që të detyrohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, të zbatoj vendimet e kuvendit të jashtëzakonshëm të aksionareve. Gjykata vlerëson se me një kërkesë të tillë nuk mund të bëhet sigurimi i kërkesëpadisë, meqenëse kërkesa e paraqitur me masën e sigurimit nuk është objekt shqyrtimi sipas padisë dhe nuk mund të ofrohet mbrojtje gjyqësore për një kërkesë të tillë, e po ashtu në rastin konkret, propozuesit e masës së sigurimit nuk kanë paraqitur asnjë provë, përmes të cilës të njëjtit do të mund të dëshmonin se i është refuzuar aplikimi për ndryshmin e të dhënave të shoqërisë, nga ana e ARBK-së, siç është përcaktuar me nenin 17 të LSHT-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar ankesën e propozuesit të masës së sigurisë brenda kufijve, gjeti se propozuesëve 1.A.R. nga Lipjani dhe 2.Euroland Group Sh.p.k, kanë paraqitë propozim për caktimin e masës së sigurisë në Dhomën e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Propozimin e ka paraqit s’bashku me kërkesëpadi me të cilën ka kërkuar kompensim të dëmit dhe përjashtim të aksionarit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë ka marë këtë vlerësim juridik se me nenit 297 pikën 1) nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se; *“Masa e sigurimit mund të caktohet; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetësimin e pasurisë së vet, me fshehejen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do*

ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.

Bazuar në dispozitën e lartëcekur duhet të plotësohen dy kushtet ligjore; propozuesi i masës së sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin dhe besueshmërinë se pa një masë të tillë kundërpropozuesi do të pamundësonte apo vështirësonte në mënyrë të dukshme realizimin e kërkesës, dhe nëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar, kundërpropozuesi do ta vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesëpadisë e sidomos me tjetërsimin e pasurisë me fshehjen e saj, me ngarkimin apo ndonjë mënyrë tjetër do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese ose në një mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e sipërmendura e që në rastin konkret janë plotësuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë fakti se në këtë fazë të procedurës janë ofruar prova dhe rrethanat lidhur me besueshmërinë e kërkesës lidhur me caktimin e masës së sigurisë, ngase nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës bëhet e besueshme se propozuesi A.R. ka në pronësi 75% të aksioneve të shoqërisë në bazë të së cilës ka të drejtën e kualifikuar në vendimmarrje dhe mund të disponojë me të drejtat që janë të përfaqësuara në aksion konform nenit 3 par 1.2 të Ligjit ne.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, andaj edhe vendimet e marra nga Kuvendi i jashtëzakonshëm të aksionarëve të shoqërisë tregtare Eurland Group sh.p.k janë vendime legjitime të marra nga organi kompetent i shoqërisë tregtare në përputhje me dispozitat e nenit 102 , 105 dhe 108 të LSHT-së. Ajo që është më kryesorja është plotësuar edhe kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurisë ngase, në rastin konkret paditësi-propozuesi ka ofruar provë se kundërpropozuesi do ti pamundësohet ose dukshëm do të vështirësonte realizimin e kërkesëpadisë, ngase kundërshtari me kontestimin e vendimeve legjitime të Kuvendit të aksionarëve dhe veprimeve tjera me të cilat pengojnë ushtrimin e kompetencave të organeve të autorizuara të shoqërisë do të mund të ndikonte në përkeqësimin e aktivitetit afarist dhe gjendjes financiare të shoqërisë. Andaj, kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe kur ka gjetur se propozimi është pjesërisht i bazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikushme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i vlerësoj edhe pretendimet ankimore të kundërshtarit të propozuesit të masës së sigurisë por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj, bazuar në të lartëcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se janë përmbushur konditat ligjore të parpara me dispozitën e nenit 297.1 nën pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1134/2024, me datën 19.06.2024

Kryetare e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2024:046588
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05836153